




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION




Emri i Biznesit: D.T.SH. "CONNECT - ISP"

Pronar: Meriton DIDA

Operatori i Shpërndarjes: CONNECT ISP

Adresa: Sheshi i Dëshmorve pn., Dragash



VENDIM

për ndërprerjen dhe shpalljen e pavlefshme të licencës së Operatorit të Shpërndarjes CONNECT ISP, me seli në Dragash

Faktet


1. Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM), në bazë të nenit 3, paragrafi 2.6. të ligjit për KPM (Ligji nr. 04/L-44), nxjerr akte nënligjore për rregullimin e transmetimit dhe të shërbimeve mediale audio-vizuale, të cilat nevojiten për të kryer funksionet e saj në pajtim me standardet ndërkombëtare.
2. CONNECT ISP është operatorë i shpërndarjes i licencuar nga Komisioni i Pavarur për Media (KPM), për shpërndarjen e shërbimeve mediale audio dhe audiovizuale përmes rrjetit kabllorë, në pajtim me Rregullorën KPM-2020/01, me seli në Dragash. KPM, me datën 30 tetor 2013, ka marr vendim për dhënien e licencës për Operatorin e Shpërndarjes CONNECT ISP.
3. Më datën 23 qershor 2021, pronari i operatorit të shpërndarjes CONNECT ISP, përmes një shkrese të dorëzuar në KPM, ka njoftuar se heqë dorë nga licenca e operatorit të shpërndarjes.

Arsyetimi

4. Në kërkesën e tij për ndërprerje të licencës, pronari i operatorit të shpërndarjes CONNECT ISP ka deklaruar se heqë dorë nga licenca e KPM-së për arsye të falimentimit të biznesit të tij.
5. Duke u bazuar në njoftimin e pronarit të operatorit të shpërndarjes CONNECT ISP, për heqje dorë nga licenca e KPM-së, Komisioni vlerëson se ka bazë të mjaftueshme për ndërprerjen dhe shpalljen e pavlefshme të licencës së operatorit të shpërndarjes CONNECT ISP.

Vendim

6. Komisioni në takimin e tij të mbajtur më datën 29 korrik 2021, merr vendim për ndërprerjen dhe shpalljen e pavlefshme të licencës së Operatorit të Shpërndarjes CONNECT ISP, me seli në Dragash, sipas njoftimit për heqje dorë nga Licenca e KPM-së, ndërsa obligimet financiare të këtij operatori të shlyhen në pajtim me legjislacionin në fuqi.
7. Këtë vendim e lëshon Komisioni, dhe i njëjti hyn në fuqi nga data e nënshkrimit.


Xhevat LATIFI

Kryetar

Komisioni i Pavarur i Mediave



29.07.2021

datë